

PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 11 NËNTOR 2025

Kryesuesi i mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes: Në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 25

Sekretari i Këshillit deklaroi kourumin prej këshilltarësh: 25

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Drejtorë të administratës.

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 0

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mirëdita të gjithëve, meqënëse kourumi është aritur, siç edhe jeni njoftuar me kërkesë të kryetarit të Bashkisë po zhvillojmë këtë mbledhje jashtë rradhe të Këshillit Bashkiak, me një pikë në rendin e ditës për dhënien trualli ndërtim për ambulancat në fshatrat Lavdar, Turan, Voskop dhe miratimin e marrëveshjes të bashkëpunimit. Kush është dakort me rendin e ditës?

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 25 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 2 e rendit të ditës.

“PËR DHËNIE TRUALLI PËR NDËRTIMIN E AMBULANCave NË FSHATRAT LAVDAR, TURAN, VOSKOP DHE MIRATIMIN E MARRËVESHJES TË BASHKËPUNIMIT SIPAS MATERIALIT BASHKËNGJITUR”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem në emër të komisionit.

Këshilltare E.Mitre: Faleminderit znj. Kryetare, përshëndetje të gjithëve, komisioni i ligjeve u mbledh dje dhe shqyrtoi materialin e sjellë nga ekzekutivi. Nga Shoqata “Gjysëm Hëna e Kuqe” është propozuar ndërtimi i tre ambulancave të tipit A2 në fshatrat Lavdar, Turan dhe Voskop kërkohet që për ndërtimin e këtyre 3 ambulancave të jepet nga pronat e Bashkisë këto njësi. Në fshatin Lavdar njësia administrative Voskopojë me pasurinë 1280, zyra kadastrale 23/90, në fshatin Turan njësia administrative Drenovë mbi pasurinë 36/12 zyra kadastrale 36/ 60 dhe në fshatin Voskop njësia administrative Voskop mbi pasurinë

341/ 2 zyra kadastrale 38/12. Dje në komision u bënë diskutime dhe ramë dakort t'ja u kalojmë për miratimin. Ambulancat e tipit a2 siç na u sqarua edhe në mbledhje janë ambulanca të një sipërfaqe të konsiderueshme të vogla prandaj quhen të tipit a2 dhe në këto fshatra ka nevojë për këto ambulanca të cilat do ndërtohen nga "Gjysëm Hëna e Kuqe".

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka ndonjë pyetje apo diskutim nga këshilltarët?

Nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit gjithë këshilltarëve që u dakortësuar për ndërtimin e këtyre ambulancave që do i shërbejnë komunitetit dhe faleminderit që morët pjesë në këtë mbledhje jashtë rradhe. Shihemi mbledhjen e rradhës!

SEKRETARE E KËSHILLIT EVA NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK ANA VERUSHI